



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Planuar / Dorezuar Priljeft/Prodato Received/Delivery	28.12.2022	viti god year	
Organ /Njësia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSTK	8498/2022		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1056/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari -kryetare, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1056/2022 të datës 24.11.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi

kundër Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike "Kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 27.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar Ankesa me numër A.nr.1056/2022 e datës 24.11.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet ne fuqi Vendimi me Nr. Ref:362/22 i datës 27.10.2022 i Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

A r s y e t i m

Ankuesi me datën 24.11.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 7374/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër vendimit me Nr.ref.362/2022 të datës 27.10.2022 të Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullosës Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, më datë 01.12.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje

në ankesë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa kjo e fundit me datë 13.12.2022 ka përcjell përgjigjen në ankesë me numër protokollit 7959/2022 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 7374/2022 të datës 24.11.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 27.10.2022 me nr.ref.362/2022 i protokolluar me date 27.10.2022 me nr.4524 i Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në MPJD; Formulari për vlerësimin e përfundimit në punë për vitin 2020; Formulari për Vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të Shërbimeve publike për kategorinë drejtuese për vitin 2021; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 01.12.2022 me numër protokollit 7533/2022; Përgjigje në ankesë e datës 13.12.2022 nga organi i punësimit me numër protokollit 7959/2022 bashkë me shkresat e lëndës; Kopja e konkursit -lëvizje brenda kategorisë i datës 20.07.2022; Lista e aplikantëve; Vendimi i datës 19.10.2022 me nr.ref.329/2022 për refuzimin e aplikacionit; Njoftimi i datës 19.10.2022 me nr.4384; Njoftim i datës 27.10.2022 me nr.ref.363/2022; Aplikacioni i datës 09.08.2022 me nr.reference RN00009451; Diplomë e datës 31.01.2005 i lëshuar nga Fakulteti Juridik në Universitetin e Prishtinës; Diploma master e datës 30.01.2013 me nr.363 të lëshuar nga Fakulteti Juridik në Universitetin e Prishtinës; Çertifikatë e datës 19.03.2009; Çertifikatë e datës 05-07.10.2009; Çertifikatë e datës 07.10.2009; Çertifikatë e datës 26.09.2010; Çertifikatë e datës 30.09.2010; Çertifikatë e datës 22.05.2011; Çertifikatë e vitit 2011; Çertifikatë e datës 13-14.10.2011; Çertifikatë i datës 29.05.2012; Çertifikatë e datës 12.10.2012; Çertifikatë e datës 09.11.2012; Çertifikatë e datës 14.02.2013; Çertifikatë e datës 13.06.2013; Çertifikatë e datës 20.04.2018; Çertifikatë e datës 09.09.2018; Çertifikatë e datës 25.02.2009; Çertifikatë e datës 19.12.2008; Çertifikatë e datës 23.12.2010; Çertifikatë e datës 22.10.2008; Çertifikatë e datës 15.01.2002; Çertifikatë e muajit dhjetor 2007; Diploma e datës 22.03.2000; Çertifikatë e datës 29.03.2007; Çertifikatë e datës 25.09.2008; Çertifikatë e datës 25.09.2008; Çertifikatë e datës 25.01.2008; Çertifikatë e datës 04.04.2008; Çertifikatë e datës 15.05.2008; Çertifikatë e datës 13.03.2007; Vërtetim për marrëdhënie pune prej datës 13.12.2011 i lëshuar nga Ministria e Drejtësisë; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i datës 14.01.2013; Kontratë e marrëdhënies së punës e datës 01.12.2010; Akt emërimi i datës 01.02.2012; Vendimi i datës 10.08.2018 me nr.01/2264-1-2018; Vendimi i datës 09.08.2018 me nr.2258-1-2018; Marrëveshje për transferim 07.08.2018; Letër rekomandimi i datës 25.08.2020; Letër rekomandimi i datës 24.11.2014; Kopja e letërnjoftimit ; Formulari për vlerësimin në punë për vitin 2020; CV e aplikuesit; Vërtetim i datës 08.08.2022 si dëshmi se nuk ka masë disiplinore dhe Ankesa e datës 24.10.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të provave të lëndës, konstatoi se ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës është konstatuar se Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me datën 20.07.2022 ka shpallur njoftimin lidhur me hapjen e konkursit me numër të referencës RN00009451 të datës 05.08.2022 deri me datën 19.08.2022 për pozitën " Drejtor i Departamentit për Çështje Ligjore dhe Traktate" Lëvizje brenda Kategorisë në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi.

Si kushte të veçanta për lëvizje brenda kategorisë janë përcaktuar: të jetë nëpunës civil i të njëjtës kategori për të cilën aplikon; të jetë nëpunës civil i të njëjtës kategori për të cilën aplikon; të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende; të jetë vlerësuar të paktën "mirë" për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit. Në rastin e konkurrimit për lëvizje brenda

kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit, ndërsa si kritere të përgjithshme formale janë përcaktuar;

Arsimimi i kërkuar: Diploma e studimeve universitare në Juridik me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to.

Përvoja e punës së paku shtatë(7) vite përvojë pune profesionale , përfshirë së paku pesë(5) vite në pozita drejtuese.

Sipas Verifikimit paraprak të Njesisë së Burimeve Njerëzore në këtë pozitë ka aplikuar vetëm një kandidat, pas verifikimit paraprak të dokumentacionit nga Njësia e Burimeve Njerëzore është vërtetuar se kandidati z. _____ nuk e ka plotësuar kriterin për përfshirje në listën e ngushtë, për arsye se nuk ka ofruar kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit sipas konkursit.

Ankuesi i pa kënaqur me Vendimin me Nr. Ref:329/22 i datës 19.10.2022 të Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. me datën 24.10.2022 ka parashtruar ankesë pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa Njësia për Burime Njerëzore në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës me vendimin Nr.362/2022 të datës 27.10.2022 ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pabazuar me arsyetimin se i njëjti nuk i ka plotësuar kriteret e konkursit siç përcaktohen në nenin 41 paragrafi 2 pika 2.4 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se "2.4. të jetë vlerësuar të paktën "mirë" për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit."

Ankuesi brenda afatit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke pretenduar se ka plotësuar të gjitha kriteret e konkursit , vlerësimet kanë qenë të ngarkuara në sistemin SIMBNJ duke pretenduar se edhe pse ka bashkangjitur dokumentet e kërkuara bashkë me ankesën prapë ju ka refuzuar ankesa me vendimin e datës 27.10.2022 përmes sistemit të SIMBNJ nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka analizuar nenin 38 paragrafin 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë i cili përcakton: paragrafi 1. *Plotësimi i pozitave të lira në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, bëhet së pari nga nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, nëpërmjet procedurës së lëvizjes brenda kategorisë. 2. Nëpunësit civilë të së njëjtës kategori në kuadër të Shërbimit Civil, që i plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e posaçme për vendin e lirë, mund të aplikojnë për plotësimin e një vendi të lirë, nëpërmjet procedurës së lëvizjes, sipas paragrafit 1 të këtij neni. Në procedurën e lëvizjes brenda kategorisë për kategorinë profesionale mund të aplikojnë vetëm nëpunësit e kësaj kategorie, të konfirmuar sipas nën paragrafit 4.1 të nenit 37 të këtij ligji.*

Bazuar në shkresat e lëndës konkretisht vendimin me Vendimin me Nr. Ref:329/22 të datës 19.10.2022 të Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës lidhur me refuzimin e aplikacionit të ankuesit të datës 09.08.2022 me nr.ref.RN00009451, Kolegji ka konstatuar se Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore ka vepruar në pajtim me nenin 45 paragrafin 2, 3 dhe 5 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbim Civil i cili përcakton; 2.Verifikimi paraprak kryhet nga NJBNJ 3.Në përfundim të verifikimit paraprak NJBNJ përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë. Vetëm këta kandidatë kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin si dhe paragrafi 5.Kandidatët, që nuk plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin. Vendimi për mosplotësimin e kushteve për aplikim, arsyetohet dhe u njoftohet individualisht aplikantëve, jo më vonë se shtatë (7) ditë kalendarike nga data e mbylljes së pranimit të



aplikimeve. Pasi që ankuesi me rastin e aplikimit në konkursin me numër ref.RN00009451 të datës 20.07.2022 në pozitën " Drejtor i Departamentit për Çështje Ligjore dhe Traktate" nuk ka sjellë dëshmitë ashtu siç është kërkuar në konkurs, andaj pretendimi i ankuesit lidhur me atë se i është bërë padrejtësi nga ana e Burimeve Njerëzore lidhur me refuzimin e aplikacionit është i pa bazuar.

Kolegji, gjatë Shqyrtimit të shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesi nuk ka ofruar dëshmi, siç janë të përcaktuara në nenin 41 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se "2.4. të jetë vlerësuar të paktën "mirë" për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit. 2.5. Në rastin e konkurrimit për lëvizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit".

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1056/2022, datë 27.12.2022

Sabile AVDYLI

Sabile Avdyli

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet;

- ❖ Ankuesit
- ❖ Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- ❖ Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.

